



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 4 regjistër (JD)
Datë 03.11.2023

Nr. 2 i vendimit
Datë 11.05.2026

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegji i Posaçëm i Apelitimit i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga gjyqtarët:

Sokol Çomo	Kryetar
Natasha Mulaj	Anëtare
Albana Shtylla	Anëtare
Ina Rama	Anëtare
Mimoza Tasi	Anëtare
Rezarta Schuetz	Anëtare

– mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelitimit, me Sekretare Gjyqësore Ina Xhetani, çështjen e Juridiksionit Disiplinor (JD) nr. 4, datë 03.11.2023, që i përket:

ANKUES:

Sali Hasa, ish-magjistrat, prokuror pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, përfaqësuar me prokurë të posaçme nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 19.04.2023, nga Prof. Dr. Ermir Dobjani dhe avokat Erajd Dobjani, me Licencë nr. {***}.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Këshilli i Lartë i Prokurorisë
Inspektori i Lartë i Drejtësisë

OBJEKTI:

1. Shfuqizimin e vendimit nr. 284, datë 17.07.2023, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, për caktimin e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra ndaj prokurorit Sali Hasa, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

2. Dërgimin e çështjes në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, i cili duhet të rishqyrtojë kërkesën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për marrjen e masës disiplinore ndaj prokurorit

Sali Hasa, mbasi të jetë shqyrtuar rekursi ndaj vendimit nr. {***}, datë 23.03.2023, të Gjykatës së Posaçme të Apelit, nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë.

3. Detyrimin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, që në kuadër të zbatimit të procesit të rregullt ligjor në procedurat administrative, mbi bazë të pretendimeve të prokurorit Sali Hasa, të fillojë hetimin disiplinor ndaj prokurorëve dhe gjyqtarëve që janë marrë me procedimin dhe gjykimin e akuzave ndaj tij dhe t'i përfshijë gjetjet e hetimit në raportin e hetimit disiplinor, që do t'i ridërgojë Këshillit të Lartë të Prokurorisë mbas përfundimit të shqyrtimit të rekursit nga Gjykata e Lartë.

BAZA LIGJORE:

Neni 148/d, pika 3 dhe neni 134, pika 1/i e Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë; neni 50, pika 4 e ligjit nr. 8577/2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; nenet 129, 182, 189, 192, 194, e 214 e ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”; nenet 6 dhe 13 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT,

pasi dëgjoji gjyqtaren relatores të çështjes Natasha Mulaj, pas shqyrtimit të ankimit dhe prapësimeve të paraqitura nga ish magjistrati Sali Hasa, prapësimeve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, dhe pasi e shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

1. Ankues Sali Hasa (në vijim “ankuesi” dhe/ose “magjistrati”) ka ushtruar detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë.
2. Me vendimin nr. {***}, datë 17.06.2021, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar ka caktuar masën e sigurimit personal “arrest në burg” për z. Sali Hasa, i akuzuar për kryerjen e veprës penale “Korrupsion pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë”, parashikuar nga neni 319/ç i Kodit Penal. Ndërsa me vendimin nr. {***}, datë 21.06.2021, kjo gjykatë ka vendosur vazhdimin e masës së sigurimit të caktuar me vendimin nr. {***}, datë 17.06.2021. Këto vendime janë miratuar më pas nga Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me vendimin nr. {***}, datë 14.07.2021.
3. Këshilli i Lartë i Prokurorisë, (në vijim “KLP”), për shkak të masës së sigurimit personal dhënë nga gjykata, ka marrë vendimin nr. {***}, datë 22.06.2021, “Për pezullimin nga detyra të z. Sali Hasa, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë”.

4. Në përfundim të procesit gjyqësor, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me vendimin nr. {***}, datë 31.05.2022, ka vendosur: (1) deklarin fajtor të të pandehurit Sali Hasa për veprën penale “Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë”, parashikuar nga neni 319/ç i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 3 (tre) vjet burgim; (2) deklarin e pafajshëm të të pandehurit Sali Hasa për veprën penale “Refuzimi për deklarin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave privatë të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarin”, parashikuar nga neni 257/a/2 të Kodit Penal, pasi nuk përbën vepër penale; (3) në zbatim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale, të pandehurit Sali Hasa i ulet 1/3 (një e treta) e dënimit të dhënë, duke e dënuar përfundimisht me 2 (dy) vjet burgim”; (4) në zbatim të nenit 59 të Kodit Penal urdhërohet pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim, duke vënë në provë të pandehurin Sali Hasa, për një periudhë prove prej 4 (katër) vitesh, me kusht që gjatë kësaj kohe i pandehuri të mos kryejë vepër tjetër penale. Gjatë kësaj kohe i pandehuri detyrohet të mbajë kontakte me Drejtorinë e Shërbimit të Provës që mbulon vendbanimin e tij nga e nesërmya e shpalljes së këtij vendimi; [...].
5. Në bazë të ankimit të ushtruar mbi këtë vendim, Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me vendimin nr. {***}, datë 23.03.2023 ka vendosur: [...] (2) ndryshimin e vendimit nr. {***}, datë 31.05.2022 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar lidhur me të pandehurin Sali Hasa, si më poshtë: - deklarin fajtor të pandehurit Sali Hasa për kryerjen e veprës penale “Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë”, parashikuar nga neni 319/ç i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 3 (tre) vjet burgim; - deklarin fajtor të pandehurit Sali Hasa për veprën penale “Refuzimi për deklarin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave private të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarin”, parashikuar nga neni 257/a/2 të Kodit Penal dhe dënimin e tij me 1 (një) vit burgim”; - në aplikim të nenit 55/2 të Kodit Penal, bashkimin e dënimeve dhe dënimin e të pandehurit Sali Hasa me një vendim të vetëm 3 (tre) vjet e 6 (gjashtë) muaj burgim. – në zbatim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale, dënimin përfundimisht të pandehurit Sali Hasa me 2 (dy) vjet e 4 (katër) muaj burgim”; - Vuajtja e dënimit të bëhet në një burg të sigurisë së zakonshme. [...].
6. Më datë 23.03.2023 lëshohet urdhri i ekzekutimit të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar “Për ekzekutimin e vendimit penal nr. {***}, datë 31.05.2022 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, të ndryshuar me vendimin nr. {***}, datë 23.03.2023, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për të dënuarin Sali Hasa, sipas pjesës përshkruese të këtij urdhri dhe sipas vendimit të formës së prerë”.
7. Bazuar në vendimet e Prokurorisë së Posaçme, Gjykatave të Posaçme, të Shkallës së Parë dhe Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Inspektori i Lartë i Drejtësisë (në vijim “ILD”) me vendimin nr. {***}, datë 06.04.2023, ka vendosur: “Për fillimin e hetimit

disiplinor me iniciativë ndaj magjistratit Sali Hasa, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë”.

8. Me vendimin nr. {***}, datë 15.05.2023 “Për përfundimin e hetimit disiplinor me iniciativë ndaj veprimtarisë së magjistratit Sali Hasa, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë”, ILD ka vendosur: [...] ii. *Fillimin e procedimit disiplinor me iniciativë ndaj magjistratit Sali Hasa, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë, për shkelje disiplinore të parashikuara nga neni 148/d, pika 2, shkronja “b” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nga neni 104, pika 3, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; iii. propozimin e masës disiplinore “shkarkim nga detyra”, të parashikuar nga neni 148/d pika 2, shkronja “b” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë nga neni 111, i ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, për shkeljen disiplinore të parashikuar në pikën 2 të këtij vendimi [...]. Me shkresën nr. {***} prot., datë 15.05.2023 ILD ia përcjell kërkesën për fillimin e procedimit disiplinor KLP-së.*
9. KLP-ja, me vendimin nr. 284, datë 17.07.2023, “Për caktimin e masës disiplinore ndaj magjistratit Sali Hasa, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë”, ka vendosur: “1. Pranimin e kërkesës nr. {***} prot., datë 15.05.2023 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për procedim disiplinor ndaj prokurorit Sali Hasa, për shkelje disiplinore të parashikuara nga neni 148/d, pika 2, shkronja “b” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nga neni 104, pika 3, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar; 2. Dhënien e masës disiplinore “shkarkim nga detyra” për magjistratin Sali Hasa, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë; 3. Pezullimin e përfitimit të pagës në masën 50%, si dhe përfitimet e tjera të magjistratit derisa vendimi të marrë formë të prerë. [...] 6. Kundër këtij vendimi lejohet ankim sipas ligjit në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit pranë Gjykatës Kushtetuese brenda afatit të përcaktuar nga neni 50, pika 4 e ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, afat i cili fillon nga data e njoftimit të vendimit të arsyetuar. [...]”.
10. Vendimin e mësipërm të KLP-së, e ka kundërshtuar ankuesi, me objekt kërkesat e përcaktuara në pjesën hyrëse të këtij vendimi, që në mënyrë të përmbledhur, konsistojnë në: (i) shfuqizimin e vendimit nr. 284, datë 17.07.2023 KLP-së, si i papajtueshëm me Kushtetutën; (ii) dërgimin e çështjes në KLP, deri në shqyrtimin e rekursit nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, si dhe (iii) detyrimin e ILD-së, të fillojë hetimin disiplinor ndaj prokurorëve dhe gjyqtarëve që kanë proceduar dhe gjykuar akuzat ndaj ankuesit dhe përfshirjen e rezultateve të këtij hetimi, në raportin e hetimit disiplinor që do t’i ridërgojë KLP-së për ankuesin Sali Hasa.
11. Kolegji i Shqyrtimit Paraprak, me vendimin nr. 4/1 (JD), datë 01.02.2024, vendosi të kalojë për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve ankimin e magjistratit Sali Hasa dhe ftoi subjektet e interesuara që të paraqesin parashtrimet e tyre me shkrim.

I. SHKAQET E ANKIMIT TË PARAQITURA NGA ANKUESI DHE PRETENDIMET E PARASHTRUARA NË KOLEGJIN E POSAÇËM TË APELIMIT

I/1. Shkaqet e ankimit /parashtrimet e ankuesit

12. Në ankim dhe në parashtrimet e paraqitura në Kolegjin e Posaçëm të Apelit (në vijim “Kolegji”), ankuesi ngre këto pretendime:

12.1. Procesi i shqyrtimit të kërkesës së ILD-së në KLP është një proces i parregullt ligjor, në trajtimin e kërkesave dhe ankesave të paraqitura prej ankuesit gjatë këtij procesi.

12.2. Shqyrtimi i çështjes vetëm mbi bazën e të dhënave të vendimit penal të Gjykatës së Posaçme të Apelit, e ka kthyer KLP-në në një organ formal, ndërkohë që është një organ i vetëqeverisjes së prokurorëve të Republikës së Shqipërisë, por që nuk kryen asnjë hetim administrativ paraprak për pretendimet administrative të prokurorëve që procedohen. KLP-ja vetëm “noterizon” kërkesat e Prokurorisë së Posaçme për marrjen e masave të pezullimit dhe vendimet e Gjykatës së Posaçme, për shkarkimin nga detyra të prokurorëve.

12.3. Vendimi nr. 284, datë 17.07.2023, duhet shfuqizuar, pasi KLP-ja duhet të pezullonte shqyrtimin e kërkesës së ILD-së dhe marrjen e vendimit, derisa të shqyrtohej rekursi i ankuesit nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë.

12.4. Arsyetimin e KLP-së, që bazuar në nenin 148/d, pika 2, shkronja “b” të Kushtetutë, nenin 104, pika 3 të ligjit nr. 96/2016 dhe nenin 462, pika 3, shkronja “b” të Kodit të Procedurës Penale, e ka konsideruar vendim gjyqësor të formës së prerë, vendimin nr. {***}, datë 31.05.2022, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, ndryshuar pjesërisht me vendimin nr. {***}, datë 23.03.2023, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, vjen në kundërshtim me jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese, Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut¹, si dhe me vendimin unifikues nr. 2, datë 03.11.2014, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, që ka interpretuar terminologjinë “vendim i ekzekutueshëm”, “vendim i formës së prerë” dhe “gjë e gjykuar”.

12.5. Në bazë të nenit 441 të Kodit të Procedurës Penale², Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, përveç prishjes ose lënies në fuqi të vendimeve të gjykatave të faktit, mund të vendosë edhe ndryshimin e vendimit për cilësimin ligjor të veprës penale, llojin dhe masën e dënimit, pasojat civile, si dhe prishjen e vendimit dhe zgjidhjen përfundimisht të çështjes pa e kthyer për rishqyrtim, kur zbatimi i ligjit material dhe procedural nuk diktohet nga nevoja për rivlerësimin e fakteve apo provave të çështjes. Në këto kushte, pas shqyrtimit të rekursit, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë mund të vendosë edhe pushimin e gjykimit dhe/ose deklarimin e pafajshëm të magjistratit Sali Hasa.

12.6. KLP-ja dhe ILD-ja si organe të administratës shtetërore/publike ushtrojnë veprimtarinë e tyre në bazë të Kushtetutës, ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si

¹ Shih vendimin e çështjes “Gjyli kundër Shqipërisë”.

² Me ndryshimet e ligjit nr. 41/2021, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.03.1995, “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar”.

dhe Kodit të Procedurave Administrative. Referuar nenit 66, pika 1 e këtij kodi³, shqyrtimi i kërkesës së ILD-së nga KLP-ja duhej pezulluar deri sa të merrej vendimi i shqyrtimit të rekursit nga Gjykata e Lartë.

12.7. Ankuesi ka paraqitur në KLP parashtrësë që vënin në dyshim procedurën dhe faktet në kërkesën e ILD-së, duke kërkuar verifikimin e tyre në kuadër të respektimit të procesit të rregullt ligjor edhe në procedurat administrative, pasi këto pretendime jo vetëm që lidheshin me veprimtarinë e këtij këshilli, por edhe sepse prokurori Sali Hasa nuk kishte rrugë dhe organ tjetër ku t'i paraqiste.

12.8. Në parashtrësat e depozituara në ILD, ankuesi pretendon shkelje të ligjit procedural penal, pasi çështja penale në ngarkim të tij është marrë nga prokurori i Prokurorisë së Posaçme pa zhvilluar procedurat e shortit, si dhe në shkelje të rënda të parimeve të objektivitetit e transparencës në hetimet paraprake të procedimit penal nr. {***} të vitit 2021. ILD-ja nuk ka ushtruar asnjë proces hetimi mbi këto shkelje, hetimi i thelluar i të cilave, mund ta shfaqësonin prokurorin nga akuza për veprën penale të korrupsionit pasiv.

12.9. Ndaj prokurorit Sali Hasa nuk është zbatuar parimi kushtetues i barazisë para ligjit dhe është mbajtur standard i ndryshëm, në raport me sjelljen e Prokurorisë së Posaçme dhe KLP-së ndaj prokurorit E. H., ndaj të cilit kishte më tepër prova për ta akuzuar për veprën penale të korrupsionit pasiv sesa indicie që janë konsideruar si prova për të dënuar prokurorin Sali Hasa.

12.10. Ankuesi pretendon shkelje të nenit 6, pika 3, shkronja “b” e Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (në vijim “KEDNJ”), lidhur me kohën dhe lehtësitë e nevojshme për përgatitjen e mbrojtjes në gjykatë, për shkak të volumit të dosjes penale të hetimeve paraprake, si dhe mënyrës së paraqitjes së akteve dhe të dhënave në të.

12.11. Ankuesi i kërkon Kolegjit gjithashtu të vlerësojë edhe pretendimin e tij lidhur me zbatimin e dispozitave për fillimin e afatit të hetimeve për procedimin penal nr. {***} në ngarkim të Sali Hasës. Pasi duke i lënë në dorë prokurorit që të vendosë kohën për regjistrimin e emrit të personit të dyshuar në regjistrimin e njoftimit të veprave penale, e lejon atë të abuzojë me kohën e zgjatjes së hetimit të veprës penale. Po kështu lejimi i përgjimit telefonik 15-ditor dhe mbajtja në vëzhgim të fshehtë përpara regjistrimit të emrit si i dyshuar, shkel rëndë privatësinë e ankuesit në cenim të nenit 36 të Kushtetutës⁴.

I/2. Parashtrimet e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, datë 07.03.2024

13. KLP-ja nëpërmjet parashtrimeve, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i” e Kushtetutës, neneve 71 dhe 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 8577/2000”), ka kërkuar rrëzimin e ankimit të ankuesit, subjekt procedimi disiplinor, prokurorit

³ “Nëse organi publik që zhvillon procedurën përballet me një çështje, zgjidhja e së cilës është parakusht për zgjidhjen e procedurës dhe që përbën një çështje ligjore të pavarur, për zgjidhjen e së cilës është kompetent një gjykatë ose organ tjetër (“çështja paraprake”), organi publik që zhvillon procedurën administrative pezullon procedurën deri në marrjen e një vendimi të formës së prerë për çështjen paraprake dhe njofton palën në lidhje me këtë”.

⁴ “Liria dhe fshehtësia e korrespondencës ose e çdo mjeti tjetër të komunikimit janë të garantuara”.

Sali Hasa, si të pabazuar në prova e në ligj dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 284, datë 17.07.2023. Në mënyrë të përmbledhur, KLP parashtron si më poshtë:

13.1. Pretendimet e ankuesit në Kolegj, janë të njëjtat me ato të paraqitura pranë KLP-së, e cila iu ka dhënë përgjigje shteruese në arsyetimin e vendimit të saj. Neni 5, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” ekuivalenton gjykimin e Kolegjit me atë të Gjykatës Kushtetuese, duke i dhënë në këtë mënyrë Kolegjit, atributet që burojnë nga ligji për Gjykatën Kushtetuese, dhe nga ana tjetër, proporcionalisht ngarkon gjithë subjektet kërkuese/ankimuese të përmbushin detyrimet në referim të këtij ligji. Ankuesi ka dështuar të ngrëjë pretendime në nivel kushtetues, për të cilat të merrte legjitimim formal dhe substancial në referim të cenimit/mohimit të të drejtave, lirive dhe garancive kushtetuese.

13.2. Në referim të pikës 4 dhe 5 po të nenit 27 të këtij ligji⁵, ankimi objekt gjykimi nuk përmbush kriteret e pranueshmërisë, e si i tillë, nuk duhet bërë objekt gjykimi.

13.3. Lidhur me pretendimin se KLP-ja ka marrë një vendim formal për shkarkimin nga detyra. Në interpretim të nenit 1, pika 2 dhe nenit 32 të Kodit Penal, referuar marzhit të dënimit të parashikuar nga nenet 319/ç dhe 257/a/2 të këtij kodi, për të cilat është dhënë dënimi ndaj ish magjistratit Sali Hasa, rezulton se ai është deklaruar fajtor për vepra penale që parashikohen nga ligji si krim. Nga interpretimi i nenit 462, pika 3, shkronja “b” dhe 428, pika 1, shkronja “b” të Kodit të Procedurës Penale, vendimi penal me të cilin është dënuar ish magjistrati Sali Hasa është një vendim i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm.

13.4. Referuar dispozitave kushtetuese dhe ligjore, përkatësisht, nenit 148/d, pika 1 dhe 2 të Kushtetutës dhe neneve 104, pika 3 dhe 111, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 96/2016, në mënyrë të qartë përcaktohet se magjistrati i cili dënohet me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi, ndaj tij jepet vetëm masa disiplinore “shkarkim nga detyra”.

13.5. Në rastin konkret prokurori është dënuar për dy krime relativisht të rënda, e për këtë shkak gjykata ndaj tij ka aplikuar llojin e dënimit me burgim, i cili është ekzekutuar. Vendimi penal është i formës së prerë dhe është dhënë për vepra penale të cilat kanë si pasojë cenimin e figurës së magjistratit në dhënien e drejtësisë, gjë e cila e bën legjitime masën disiplinore të shkarkimit të vendosur nga KLP, pasi në këtë rast është cenuar rëndë besimi në publik i magjistratit dhe është jashtë çdo logjike të ligjit që magjistrati të qëndrojë në detyrë duke pezulluar procedimin disiplinor.

13.6. Procedura e shqyrtimit të çështjes nga KLP është zbatuar konform përcaktimeve kushtetuese e ligjore, duke garantuar të drejtat e ankuesit, i cili nuk shpreh asgjë konkrete përveçse një opinion

⁵ Neni 27, pika 4 dhe 5 të ligjit nr. 8577/2000, parashikon: “4. Kërkesa që plotëson kriteret e parashikuara në pikën 2, të këtij neni, regjistrohet në regjistrin e posaçëm që mbahet nga Drejtoria Gjyqësore pranë Gjykatës Kushtetuese. 5. Kërkesa që nuk plotëson kriteret e parashikuara në pikën 2, të këtij neni, konsiderohet e paplotë dhe nuk regjistrohet në regjistrin e kërkesave. Drejtoria Gjyqësore njofton kërkuesin që brenda 10 ditëve të bëjë plotësimet e nevojshme. Në rast se kërkuesi nuk e paraqet kërkesën të plotësuar ose brenda afatit të caktuar nga Drejtoria Gjyqësore, kërkesa arkivohet”.

negativ që nuk ka asnjë vlerë sa i takon shqyrtimit të ankimit, pasi legjislatori shkarkimin nga detyra e lidh me akte dhe sjellje që cenojnë figurën e prokurorit, kur ai është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë.

13.7. Pretendimi se vendimi i Gjykatës së Posaçme të Apelit është i pazbatueshëm për sa kohë rekursi nuk është shqyrtuar nga Gjykata e Lartë, dhe nuk ka fituar fuqinë e *res judicata* dhe, si i tillë, nuk është një vendim përfundimtar, vjen në kundërshtim me dispozitat kushtetuese e ligjore të përmendura më sipër. Në këtë rast legjislatori nuk ka dhënë ndonjë alternativë për një masë tjetër disiplinore, si dhe ka përdorur termin “vendim i formës së prerë për kryerjen e një krimi” dhe nuk ka përdorur një term tjetër ashtu si interpreton ankuesi.

13.8. Vendimi i formës së prerë është i detyrueshëm për të gjitha institucionet, edhe për KLP-në, që sipas detyrave të caktuara në ligj detyrohet të shqyrtojë edhe procedimin disiplinor të prokurorëve, dhe me të drejtë nuk kishte arsye përse të pezullonte procedimin disiplinor deri sa të shqyrtohej në Gjykatën e Lartë rekursi ndaj vendimit penal të formës së prerë.

13.9. Sipas vendimit unifikues nr. 2, datë 03.11.2014, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, vendimi i Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, ndonëse nuk ka marrë ende statusin e “gjësë së gjykuar” është i formës së prerë dhe menjëherë i ekzekutueshëm. KLP-ja në asnjë rast nuk ka pretenduar se vendimi i Gjykatës së Posaçme të Apelit është përfundimtar dhe as nuk i ka mohuar në asnjë fazë të procesit të drejtën ankuesit për të shteruar të gjitha mjetet juridike që ai disponon. KLP-ja nuk ka vënë në diskutim, në asnjë moment të drejtën e ankimit, si pjesë esenciale e një procesi të rregullt ligjor, por kjo nuk e pengon atë të marrë vendimin e shkarkimit nga detyra, sipas dispozitave urdhëruese të ligjeve të posaçme.

13.10. Rekursi ndaj vendimit të Gjykatës së Posaçme të Apelit për dënimin e ankuesit, nuk pezullon fuqinë ekzekutive të vendimit të saj dhe nuk pengon KLP-në për shkarkimin e magjistratit nga detyra. Po kështu edhe Gjykata Kushtetuese në vendimin nr. 55, datë 31.03.2021, ka vlerësuar se shprehja e vënë në dyshim nga Gjykata e Lartë “formë e prerë” është përdorur nga legjislacioni procedural edhe në raste të tjera, pa penguar kontrollin gjyqësor deri në Gjykatën e Lartë. Pretendimi për pezullimin e procedimit disiplinor është paraqitur dhe gjatë shqyrtimit të çështjes në KLP, dhe është rrëzuar si kërkesë duke vazhduar shqyrtimin e procedimit disiplinor, duke vendosur përfundimisht shkarkimin nga detyra.

13.11. Për pezullimin e shqyrtimit të procedimit disiplinor, duke referuar në nenin 66/1 të Kodit të Procedurave Administrative, KLP-ja parashtroi se në rastin në shqyrtim zbatohet ligji specifik, përkatësisht, neni 145 lidhur me nenin 126, pika 2 e ligjit nr. 96/2016, nga interpretimi i të cilave saktësohet se pezullimi i procedimit disiplinor nga KLP-ja është i kufizuar deri në dhënien e vendimit të formës së prerë.

13.12. Lidhur me pretendimet se çështja penale në ngarkim të ankuesit, është marrë nga prokurori pa zhvilluar procedurat e shortit, hetimi penal nuk ka qenë objektiv, i paanshëm dhe transparent, si dhe nuk është marrë në konsideratë kërkesa për zëvendësimin e prokurorit, këto pretendime nuk zgjidhen kryesisht nga KLP-ja, pasi nuk ka pasur objekt shqyrtimi dhe një kërkesë të tillë nga ILD.

Kjo është një çështje që trajtohet nga nenet 26 dhe 27 të Kodit të Procedurës Penale dhe për sa kohë rekursi ndodhet për shqyrtim në Gjykatën e Lartë, vetëm kjo e fundit mund të shprehet me vendim përfundimtar nëse këto pretendime janë paraqitur në rekurs.

13.13. Pretendimet ndaj çështjeve penale që u përkasin personave të tretë që nuk kanë lidhje me objektin e procedimit disiplinor duke kërkuar nga KLP-ja të ndjekë të njëjtën praktikë në shqyrtimin e këtij rasti, duke pretenduar për shkelje procedurale nga prokurorët e Prokurorisë së Posaçme, të cilët sipas tij kanë cenuar parimin e barazisë para ligjit dhe të vepruarit me dy standarde duke mbrojtur dhe favorizuar prokurorët e tjerë e duke ndërmarrë një proces hetimi të padrejtë ndaj prokurorit Sali Hasa, nuk zgjidhen kryesisht nga KLP-ja, kur nuk ka pasur objekt shqyrtimi për këto çështje të pretenduara prej tij, pasi nuk ka një kërkesë të tillë për shqyrtim nga ILD-ja. Veç kësaj, këto pretendime janë çështje që i përkasin hetimit penal nga ana e prokurorëve të cilët në çdo rast për çdo vendim të tyre, i nënshtrohen kontrollit gjyqësor nëpërmjet gjyqtarit të seancës paraprake që ka dhënë vendim, sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurës Penale. Për sa kohë këto vendime janë të formës së prerë nuk mund të vlerësohen të padrejta, derisa nuk janë revokuar nga gjyqtari i seancës paraprake.

13.14. Lidhur me pretendimet e ankuesit se ndaj tij faktet e evidentuara nga prokurori i çështjes nuk përputhen me përmbajtjen reale që kanë dokumentet, për rrjedhim, sipas tij hetimet tej çdo dyshimi janë joobjektive, të njëanshme dhe jo transparente, deri në këto momente janë hipotetike dhe nuk janë vërtetuar nga kontrolli gjyqësor i një gjykate më të lartë me një vendim gjyqësor të formës së prerë.

I/3. Parashtrimet e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, datë 09.03.2024

14. ILD-ja parashtron se kërkesa e ankuesit duhet të mos pranohet, duke arsyetuar në mënyrë të përmbledhur si më poshtë.

14.1. Në drejtim të procesit të rregullt ligjor, të gjitha veprimet e kryera dhe aktet e nxjerra nga ILD gjatë kryerjes së veprimtarisë hetimore janë realizuar në respektim të këtij parimi. Ankuesi është njoftuar me vendimmarrjet e ILD-së dhe i janë bërë me dije të drejtat dhe detyrimet ligjore.

14.2. Parashtrësat e ankuesit të datës 26.04.2023 dhe të datës 03.05.2023, janë referuar në përmbajtjen e raportit të përfundimit disiplinor ndaj magjistratit⁶, si dhe janë bërë pjesë e dosjes hetimore të përcjellë pranë KLP-së. Për pasojë, pretendimet e ngritura në lidhje me rezerva sa i takon përcjelljes së këtyre dy dokumenteve pranë KLP-së janë tërësisht subjektive dhe të pambështetura.

14.3. ILD ka bërë vlerësimin të pavarur të parashtrimeve dhe argumenteve të ngritura nga ankuesi. Kjo nuk nënkupton mangësi në realizimin e një procedure të plotë dhe të gjithanshme të hetimit disiplinor, por përkundrazi ILD ka vepruar bazuar në diskrecionin që Kushtetuta dhe ligji i jep për fillimin dhe kryerjen e një procesi të plotë dhe të gjithanshëm hetimi disiplinor në funksion të

⁶ Shih paragrafin 16.4 të raportit nr. {***}, datë 11.05.2023, "Për hetimin disiplinor me iniciativë ndaj magjistratit Sali Hasa, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë".

respektimit të procesit të rregullt ligjor. Fakti që qëndrimet e mbajtura nga ILD-ja nuk i përgjigjen pritshmërisë së magjistratit apo nuk mbajnë në konsideratë pretendimet e tij, nuk mund të nënkuptojë cenim të standardit të procesit të rregullt ligjor.

14.4. Në lidhje me pretendimet e ankuesit për mosshqyrtimin nga ILD të ankimit me shkrim ndaj veprimtarisë të prokurorit A.D. dhe gjyqtarit Sh. L., të paraqitura ndërmjet parashtrësve gjatë fazës së hetimit disiplinor, ILD shprehet se ankuesi mund të pretendojë një tërësi faktesh dhe mund të identifikojë në ankesë çdo lloj shkelje disiplinore që ai pretendon se ka ndodhur, por është ILD-ja që, në mënyrë të pavarur dhe në përputhje me ligjin për statusin e magjistratit, bën një cilësim të fakteve, veprimeve/mosveprimeve që lidhen me shkeljen disiplinore që pretendohet në ankesë pa u lidhur me përcaktimin që mund të pretendojnë personat fizik/juridik. Kushtetuta dhe ligji i garantojnë ILD diskrecion për fillimin dhe kryerjen e një procesi të plotë dhe të gjithanshëm hetimi në funksion të respektimit të procesit të rregullt ligjor. Në fazën e hetimit disiplinor, ILD kryen një vlerësim të pavarur të fakteve në përputhje me objektin e hetimit disiplinor, pavarësisht fakteve të parashtruara apo të kërkuara nga ankuesi/magjistrati. Parashtrësja e paraqitur nga magjistrati gjatë fazës së hetimit disiplinor, si mjet procedural në dispozicion të magjistratit subjekt hetimi disiplinor ka si qëllim garantimin e të drejtës së tij për t'u dëgjuar dhe për të shprehur pretendimet e tij bazuar në objektin e hetimit disiplinor.

14.5. Referuar jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut⁷, e drejta për t'u dëgjuar nga gjykata është element i rëndësishëm i procesit të rregullt ligjor, për faktin se shërben për të mbrojtur në substancë të drejtën që pretendohet si e shkelur dhe lidhet kryesisht me të drejtën për të bërë kërkime/parashtrime dhe për të marrë përgjigje për to. E drejtë e cila është realizuar plotësisht gjatë hetimit dhe procedimit disiplinor të zhvilluar respektivisht nga ILD dhe KLP. Pretendimet e ngritura nga ankuesi për cenim të parimeve të procesit të rregullt ligjor janë tërësisht të pambështetura.

14.6. Në lidhje me pretendimin se nga ILD dhe KLP në cilësinë e organeve administrative duhet të ishin zbatuar parashikimet e Kodit të Procedurave Administrative për pezullimin e procedurës disiplinore deri në përfundimin e gjykimit të rekursit në Kolegji Penal të Gjykatës së Lartë, ILD parashtron se në kuadër të zhvillimit të veprimeve hetimore dispozitat e ligjit nr. 96/2016 plotësohen me parashikimet e Kodit të Procedurave Administrative, vetëm me përjashtim të rasteve dhe për aq sa ky ligj nuk parashikon ndryshe. Ligji për statusin e magjistratit ka parashikuar në mënyrë të detajuar dhe shteruese rregullat e dhe rastet e pezullimit të procedurës së hetimit disiplinor, në nenin 126 të tij. Në këtë rast nuk jemi përpara aplikimit të kësaj dispozite pasi hetimi disiplinor me iniciativë nga ILD ka filluar pasi çështja penale në ngarkim të magjistratit është gjykuar me vendim gjyqësor të formës së prerë.

14.7. Referuar nenit 148/d, pika 2 shkronja “b” e Kushtetutës, shkarkimi nga detyra vjen si pasojë e një vendimi gjyqësor që e deklaron prokurorin fajtor për kryerjen e një krimi dhe nuk presupozon vlerësim dhe diskrecion nëse duhet marrë masa e shkarkimit nga detyra apo jo. Kjo është qartësisht

⁷ *Shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr. 12/2005, nr. 8/2006, si dhe vendimin e KPA nr. 1, datë 20.02.2023, paragrafi 14.1.2.1, vendimin e GJEDNj-së çështja “Dory kundër Suedisë”, paragrafi 37.*

e sanksionuar jo vetëm në këtë dispozitë kushtetuese, por edhe në përmbajtjen e nenit 104, pika 3 e ligjit nr. 96/2016, dispozitë e cila ka parashikuar që masa disiplinore e shkarkimit nga detyra jepet vetëm në rastin kur magjistrati është dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi. Në këtë rast procedurat disiplinore të detajuara në këtë ligj zbatohen *për aq sa është e nevojshme*. Jo pa arsye, legjislatori ka vendosur këtë term, pasi dënimi penal me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi përbën një fakt me vërtetimin e të cilit, ILD-ja është e detyruar të iniciojë procedurën disiplinore dhe të paraqesë kërkesën për fillimin e procedimit disiplinor duke propozuar vetëm masën e shkarkimit nga detyra dhe Këshilli përkatës ta finalizojë atë procedurë nëpërmjet dhënies së masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.

14.8. Gjatë hetimit dhe procedimit disiplinor rezultoi e provuar përmbushja e dy kriterëve të parashikuara nga neni 148/d, pika 2, shkronja “b” e Kushtetutës, vendimi nr. {***}, datë 23.03.2023, i Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar konsiderohet vendim i formës së prerë referuar parashikimeve të nenit 462, pika 3, shkronja “b” dhe nenit 428, pika 1, shkronjat “a” dhe “b” të Kodit të Procedurës Penale, si dhe referuar neneve 1/2, 32, si dhe neneve të pjesës së posaçme përkatësisht 319/ç, 257/a/2 të Kodit Penal, ankuesi është dënuar për kryerjen e një krimi.

II. VLERËSIMI I KOLEGJIT TË POSAÇËM TË APELIMIT

A. Juridiksioni Disiplinor i Kolegjit të Posaçëm të Apelit

15. Në përputhje me nenin 179, pika 7 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë⁸, nenin 5, pika 3, shkronja “b” të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”⁹, si dhe nenin 192, pika 1 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”¹⁰, Kolegji i Posaçëm i Apelit ka juridiksion *ratione materiae* për të shqyrtuar ankimin ndaj vendimit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra të prokurorit Sali Hasa.
16. Nën dritën e këtyre dispozitave kushtetuese dhe ligjore, shqyrtimi i kësaj çështjeje kryhet në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 8577/2000. Kolegji i Shqyrtimit Paraprak, me vendimin nr. 4/1 (JD), datë 01.02.2024, konkludoi se ankimi i plotëson kërkesat për t’i kaluar për shqyrtim në

⁸“7. Gjatë mandatit të tyre nëntëvjeçar, gjyqtarët e Kolegjit të Apelit, sipas nenit 179/b, kanë juridiksion disiplinor ndaj gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Prokurorit të Përgjithshëm dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Kolegji i Apelit shqyrton ankimet ndaj vendimeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për vendosjen e masave disiplinore, përkatësisht ndaj gjyqtarëve, prokurorëve dhe inspektorëve të tjerë.”

⁹“[...]3. Kolegji i Apelit gjatë mandatit të tij, në përputhje me Kushtetutën, ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese” dhe legjislacionin që rregullon çështjet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë, ka juridiksion të shqyrtojë:[...], b. ankimet kundër vendimeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë për vendosjen e masave disiplinore ndaj gjyqtarëve, prokurorëve dhe inspektorëve të tjerë.

¹⁰ “[...] Aktet administrative individuale që vendosin masa disiplinore mbi prokurorët, ankimohen në Gjykatën Kushtetuese”.

seancë plenare mbi bazën e dokumenteve Mbledhjes së Gjyqtarëve të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, pasi plotëson kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000.

16.1. Në çështjen objekt shqyrtimi, Kolegji vlerëson se ankuesi legjitimohet *ratione personae*, sipas pikave 2/b e 2/c të nenit 31/a të ligjit nr. 8577/2000, pasi kërkesa është paraqitur nga subjekti i legjitimuar me interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar, dhe është nënshkruar nga ai vetë dhe përfaqësuesit ligjor me prokurën e posaçme nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 19.04.2023.

16.2. Ankuesi legjitimohet *ratione temporis*, pasi ankimi është protokolluar në Kolegji në datën 03.11.2023, brenda afatit 4-mujor të përcaktuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 8577/2000, nga njoftimi i vendimit të arsyetuar të KLP-së, më 25.07.2023.

16.3. Në lidhje me shterimin e mjeteve juridike, bazuar në nenin 179, pika 7 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, juridiksionin disiplinor kundër vendimeve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, gjatë mandatit 9-vjeçar, e ushtron Kolegji i Posaçëm të Apelimit. Me fjalë të tjera, ankuesi nuk ka mjet tjetër ligjor ankimi, përveç atij drejtuar Kolegjit. Kërkimet në ankimin objekt shqyrtimi, nuk rezultojnë të kenë qenë objekt i një vendimi të mëparshëm të Gjykatës Kushtetuese. Përpos sa arsyetuar më sipër, në kushtet që nuk rezultojnë që ky kërkim të jetë ngritur e trajtuar më parë nga Gjykata Kushtetuese, as ky kriter përjashtues për shqyrtimin, nuk vërtetohet. Për rrjedhojë, ankuesi po shteron në Kolegji mjetin juridik të ankimit.

B. Vlerësimi për themelin e pretendimeve

17. Kolegji i Posaçëm i Apelimit (në vijim “Kolegji”), fillimisht mori në analizë pranueshmërinë e ankimit nën dritën e fakteve dhe rrethanave që lidhen me statusin e tij të magjistratit/prokuror, pas paraqitjes së këtij mjeti procedural dhe vendimit nr. 4/1 (JD), datë 01.02.2024, të Kolegjit të Shqyrtimit Paraprak për kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve. Ankuesi, në cilësinë e subjektit të rivlerësimit, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio* në Komision për kriterin e vlerësimit të pasurisë, në përfundim të të cilit me vendimin nr. 433, datë 03.09.2021, Komisioni ka vendosur: “*Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Sali Hasa, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë*”.

Subjekti i rivlerësimit Sali Hasa ka ushtruar ankim kundër këtij vendimi duke vënë në lëvizje Kolegjin në kuadër të juridiksionit të rivlerësimit. Kolegji me vendimin nr. 33 (JR), datë 08.07.2024, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 433, datë 03.09.2021, të Komisionit. Vendimi i Kolegjit është përfundimtar dhe me efekt të menjëhershëm, duke passjellë njëherazi mbarimin e statusit të magjistratit. Kjo situatë faktiko-ligjore, e vendos ankuesin në kushtet e parashikuara nga neni 31/a, pika 2, shkronja “dh” e ligjit nr. 8577/2000, të papranueshmërisë së ankimit në kuadër të juridiksionit disiplinor, pasi “*kërkimet e paraqitura në kërkesë janë objekt i një vendimi të mëparshëm të Gjykatës Kushtetuese, ose rivendosja në vend e së drejtës së shkelur nuk është e mundur*”.

18. Kolegji çmon se edhe në rast se do të merrte në konsideratë shkaqet e ankimit të subjektit të rivlerësimit, në kushtet e mungesës së statusit të magjistratit, si rezultat i moskalimit me sukses të

procesit të rivlerësimit, rivendosja në vend e së drejtës së pretenduar të shkelur nuk do të ishte e mundur.

19. Përpos sa më sipër, *obiter dictum* Kolegji, në kuadër të juridiksionit disiplinor, mori në analizë pretendimet e ankuesit kundër vendimit nr. 284, datë 17.07.2023, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, dhe procedurës ligjore të ndjekur, duke i analizuar ato edhe në këndvështrim të parashtrimeve që kanë bërë prezent në gjykim subjektet e interesuara, KLP-ja dhe ILD-ja. Në analizë të pretendimeve të palëve, Kolegji konstaton se ato përqendrohen kryesisht në interpretimin e efekteve juridike të vendimit të formës së prerë të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, në ekzekutueshmërinë e menjëhershme të tij nga organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë në këtë rast ILD-ja dhe KLP-ja, në kuadër të procesit disiplinor, si dhe efektet që prodhon rekursi derisa çështja të shqyrtohet nga Gjykata e Lartë e të marrë statusin e *gjësë së gjykuar*.
20. KLP-ja, bazuar në nenin 148/d, pika 2, shkronja “b” e Kushtetutës, që parashikon se: *“Prokurori shkarkohet nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë: [...] b. është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi”*, nenin 104, pika 3 e ligjit nr. 96/2016, *“Masa disiplinore e shkarkimit nga detyra jepet vetëm nëse dënimi me vendim të formës së prerë është dhënë për kryerjen e një krimi. Në këtë rast, gjatë procedurës disiplinore, parashikimet e këtij ligji zbatohen për aq sa është e nevojshme”*, ka analizuar nëse veprat penale në ngarkim të magjistratit klasifikohen në “krim”, si dhe nëse vendimi gjyqësor është i formës së prerë.

20.1. Me konsideratë përcaktimet e nenit 1, paragrafi 2 i Kodit Penal, në të cilin thuhet se: *“Veprat penale ndahen në krime dhe në kundërvajtje penale. Dallimi i tyre bëhet në çdo rast në dispozitat e pjesës së posaçme të këtij kodi”*, si dhe nenit 32 të këtij kodi se: *“Dënimi me burgim për krimet jepet për një kohë nga pesë ditë deri në tridhjetë e pesë vjet. Për kundërvajtjet penale dënimi me burgim jepet për një kohë nga pesë ditë deri në dy vjet”*, KLP-ja referuar marzhit të dënimit të parashikuar për veprat penale për të cilat është dhënë dënimi, përkatësisht “Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë”, parashikuar nga neni 319/ç i Kodit Penal, dhe “Refuzimi për deklarin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave privatë të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim” parashikuar nga neni 257/a/2 i Kodit Penal, konstaton se: *Magjistrati është deklaruar fajtor për vepra penale që parashikohen nga ligji si krim.*

20.2. Lidhur me “vendimin gjyqësor të formës së prerë”, KLP-ja i referohet nenit 462, pika 3 e Kodit të Procedurës Penale, që parashikon se: *“3. Janë vendime të formës së prerë: [...] b) vendimi i gjykatës së apelit kur zgjidh përfundimisht çështjen, sipas shkronjave “a”, “b” dhe “c”, të pikës 1, të nenit 428, të këtij Kodi¹¹; c) vendimi i Gjykatës së Lartë në rastet e ekstradimit dhe transferimit të personave të dënuar”*.

¹¹ Neni 428, pika 1, shkronjat “a”, “b” dhe “c” të Kodit të Procedurës Penale, parashikon: *“1. Gjykata e apelit, pasi shqyrton çështjen, vendos: a) lënien në fuqi të vendimit; b) ndryshimin e vendimit; c) prishjen e vendimit dhe pushimin e çështjes kur janë rastet që nuk lejojnë fillimin ose vazhdimin e procedimit; [...]”*.

20.3. Për sa më sipër, KLP-ja ka dhënë masën disiplinore të “shkarkimit nga detyra”, referuar ekzekutueshmërisë së menjëhershme të vendimit të Gjykatës së Posaçme të Apelit nën dritën e nenit 462 të Kodit të Procedurës Penale, duke mos pasur asnjë opsion të ndryshëm, në përputhje me nenin 148/d, pika 2, shkronja “b” e Kushtetutës. Sikurse ka shtjelluar, për analogji dhe Gjykata Kushtetuese, me vendimin nr. 29/2001:

“[...] Vendimet gjyqësore të formës së prerë, për çështjen konkrete që zgjidhin, kanë fuqinë e ligjit. Kjo do të thotë se, për sa kohë ato nuk janë prishur ose ndryshuar nga një gjykatë më e lartë, asnjë organ tjetër shtetëror nuk mund të mos përfillë përmbajtjen e tyre dhe të ngarkojë me përgjegjësi gjyqtarin e çështjes. Megjithatë, problemi ndryshon në rastet kur këto vendime janë shoqëruar me shkelje që diskreditojnë rëndë pozitën ose figurën e gjyqtarit dhe që cenojnë në përgjithësi prestigjin dhe autoritetin e pushtetit gjyqësor. Në raste të tilla, Këshilli i Lartë i Drejtësisë ka kompetenca të plota të marrë çdo lloj mase disiplinore ndaj gjyqtarëve, pa e kondicionuar atë me faktin nëse kjo kategori vendimesh kanë marrë formë të prerë dhe kanë fituar kështu autoritetin e gjësë së gjykuar”.

20.4. Ankuesi, nëpërmjet këtij mjeti procedural ankimi i ka kërkuar Kolegjit, *dërgimin e çështjes në KLP, i cili duhet të rishqyrtojë kërkesën e ILD-së për marrjen e masës disiplinore ndaj prokurorit Sali Hasa, mbasi të jetë shqyrtuar rekursi ndaj vendimit nr. {***}, datë 23.03.2023, të Gjykatës së Posaçme të Apelit, nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, ndërkohë nuk rezulton të ketë depozituar informacion mbi ecurinë gjyqësore të çështjes penale në ngarkim të tij, edhe pas marrjes së njoftimit në prill 2026, mbi shqyrtimin e çështjes së juridiksionit disiplinor në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve, më datë 11.05.2026.*

20.5. Nga të dhënat e pasqyruara në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë në internet, Kolegji erdhi në dijeni të faktit që Kolegji Penal i kësaj gjykate, me vendimin nr. {***}, datë 14.11.2024 ka vendosur:

*“ [...] 2. Mospranimin e rekursit të paraqitur nga i gjykuari Sali Hasa kundër vendimit nr. {***}, datë 23.03.2023, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar për akuzën për veprën penale “Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave privatë të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim”, parashikuar nga neni 257/a/2 i Kodit Penal;*

*3. Prishjen e vendimit nr. {***} datë 23.03.2023, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar për të gjykuarin Sali Hasa për akuzën për veprën penale “Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”, parashikuar nga neni 319/ç i Kodit Penal dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në këtë gjykatë me tjetër trup gjykues.”.*

20.6. Nga të dhënat në faqen zyrtare të internetit të Gjykatës Kushtetuese, rezulton se kjo gjykatë, më datë 02.04.2026, ka rrëzuar kërkesën e z. Sali Hasa, me objekt: *“Shfuqizimi pjesërisht si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i vendimit nr. {***}, datë 23.03.2023, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me të cilin është ndryshuar vendimi nr. {***}, datë 31.05.2022, i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për*

*Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar lidhur me të pandehurin Sali Hasa sipas të cilit ky ishte shpallur i pafajshëm për veprën penale “Refuzim për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave private të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim”, parashikuar nga neni 257/a/2 të Kodit Penal dhe deklarimi fajtor i të pandehurit Sali Hasa për kryerjen e kësaj vepre penale dhe dënimi i tij me 1 (një) vit burgim; i vendimit nr. {***}, datë 14.11.2024, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë me të cilin ndërmjet të tjerave është vendosur mospranimi i rekursit të paraqitur nga i gjykuari Sali Hasa kundër vendimit nr. {***}, datë 23.03.2023, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar për dënimin për veprën penale të parashikuar nga neni 257/a/2 i Kodit Penal”¹².*

20.7. Pas dërgimit të çështjes për rishqyrtim në gjykatë e apelit me tjetër trup gjykues, nga të dhënat e pasqyruara në faqen e internetit të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, rezulton se me vendimin nr. {***}, datë 18.06.2025, kjo gjykatë ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. {***}, datë 31.05.2022 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, lidhur me deklarimin fajtor për kryerjen e veprës penale “Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”, parashikuar nga neni 319/ç i Kodit Penal, si dhe llojin dhe masën e dënimit për këtë vepër penale. Referuar të dhënave në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë në internet, ankuesi ka paraqitur rekurs ndaj këtij vendimi, dhe çështja penale rezulton me “*status në proces*”.

21. Për sa analizuar më sipër, rezulton se ankuesi është deklaruar fajtor me një vendim të formës së prerë për veprën tjetër penale të parashikuar nga neni 257/a/2 i Kodit Penal, “*Fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave privatë të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publik ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet*”, vendimi i cili është përfundimtar, *res judicata*. Në këto kushte, pretendimi i ankuesit në këtë rast për shfuqizimin e vendimit nr. 284, datë 17.07.2023 dhe dërgimin e çështjes në KLP, derisa të jetë shqyrtuar rekursi ndaj vendimit nr. {***}, datë 23.03.2023, të Gjykatës së Posaçme të Apelit, nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, tashmë është pa objekt.
22. Në rrethanat aktuale, nisur nga data 14.11.2024, Gjykata e Lartë tashmë ka marrë një vendim përfundimtar, nëpërmjet mospranimit të rekursit kundër vendimit nr. {***}, datë 23.03.2023, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar për akuzën e veprës penale të parashikuar nga neni 257/a/2 i Kodit Penal, që passjell një përgjigje përfundimtare për masën disiplinore të shkarkimit nga KLP-ja.
23. Kolegji vëren se pjesë e rëndësishme e kërkimeve të ankuesit, është koncepti i vendimit të formës së prerë, marrë në analizë e shtjelluar nga Gjykata e Lartë me vendimin unifikues nr. 2/2014. Në linjë me këtë kërkim, ndërsa interpretimi i ankuesit ishte i drejtë deri në vitin 2017, me ndryshimet që ka pësuar Kodi i Procedurës Penale me ligjin nr. 35/2017, nën dritën e nenit 462, pika 3, shkronja “b”, vendimi i Gjykatës së Posaçme të Apelit dhe ekzekutimi i këtij vendimi nga prokurori, është i formës së prerë dhe nuk mund të argumentohet se lë diskrecion për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë për të mos zbatuar një dispozitë që, në mënyrë të shprehur,

¹² *Vendime përfundimtare, prill 2026 – Gjykata Kushtetuese.*

përcakton çfarë përbën vendim penal i formës së prerë, apo për të mos ndërmarrë hapat e parashikuar në mënyrë të shprehur nga Kushtetuta e ligji për mënyrën se si veprohet për magjistratët në detyrë, statusi i të cilëve rregullohet e funksionon nëpërmjet këtyre organeve, në rast se ka vendim penal për kryerjen e një krimi.

24. Në rastin kur procesi disiplinor vjen si pasojë e një procesi penal, parashikimet e Kushtetutës në nenin 148/d, pika 2, shkronja “b” dhe pika 4, shkronja “a”, nuk parashikojnë për këto organe ILD-në dhe KLP-në, një mënyrë alternative veprimi. Prosesi i hetimit disiplinor dhe vendimmarrja objekt ankimi janë kryer pasi ka nisur edhe ekzekutimi i vendimit penal, për shkak të vendimit të Gjykatës së Posaçme të Apelit, ndërsa ligji ka parashikuar edhe mënyrën e shërimit dhe rivendosjes së të drejtave, në rast se ankuesi do të kishte marrë një vendim në favor të tij pas rekursit të ushtruar në Gjykatën e Lartë. Për rrjedhojë, parë edhe në këtë këndvështrim, mënyra se si është kryer procesi disiplinor për ankuesin, është e bazuar në ligj.
25. Lidhur me pretendimet për mosrespektim të parimit të procesit të rregullt ligjor gjatë procedurave administrative të kryera nga ILD-ja dhe KLP-ja, nga natyra e këtyre pretendimeve të renditura në paragrafët 12.8 – 12.11 të këtij vendimi, Kolegji konstaton se ato nuk afektojnë procesin e rregullt ligjor në kuadër të procedimit disiplinor të zhvilluar ndaj tij, por i përkasin procesit penal, dhe janë objekt i kontrollit gjyqësor nga Gjykatat e Posaçme në të dyja shkallët e saj, Gjykata e Lartë, si dhe Gjykata Kushtetuese, në rastin e ankimit individual për shkelje të parimeve të parashikuara nga Kushtetuta dhe KEDNj-ja.
26. Në analizë të sa më sipër, nën dritën e dispozitave kushtetuese e ligjore që gjejnë zbatim, Kolegji vendosi të mos pranojë ankimin e kërkuesit, duke e gjetur atë të pabazuar në ligj dhe akte. Ky vlerësim mban në konsideratë që procedimi disiplinor i kryer për ankuesin rezulton të ketë qenë në respektim të plotë të të drejtave për proces të rregullt nga njëra anë, dhe të faktit që, nga ana tjetër, në ngarkim të tij, ka një dënim penal për një krim të kryer me dashje. Dy institucionet e referuara më sipër [ILD-ja dhe KLP-ja] rezulton të kenë vepruar në përputhje me tagrat e tyre kushtetuese e ligjore, duke çelur hetimin disiplinor dhe ndërmarrë veprimet e parashikuara nga Kushtetuta dhe ligjet që rregullojnë rrethanat ligjore konkrete.
27. Për sa më sipër arsyetuar, Kolegji vlerëson se ankimi i ankuesit Sali Hasa, kundër vendimit nr. 284, datë 17.07.2023, i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, nuk duhet të pranohet.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Posaçëm i Apelimit, në mbështetje të neneve 31/a, pika 2, shkronja “dh” dhe 71/a, pika 1, shkronja “ç” e ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

VENDOSI:

Mospranimin e ankimit të ankuesit Sali Hasa kundër vendimit nr. 284, datë 17.07.2023, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, “Për caktimin e masës disiplinore ndaj prokurorit Sali Hasa, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë”.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 11.05.2026

Shpallur më 11.06.2026

GJYQTARE

Ina RAMA

nënshkrimi

GJYQTARE

Mimoza TASI

nënshkrimi

GJYQTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

GJYQTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

GJYQTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

KRYETAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi